





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GLLOGOCIT (DRENASIT)
OPSTINA GLOGOC- MUNICIPALITY OF GLLOGOC



Programi Komunal Tre Vjeçar për Banim

2019-2021



Tetor 2018

LLOJI I DOKUMENTIT: PROGRAMI KOMUNAL PËR BANIM 2019-2021

ZYRA E KRYETARIT TE KOMUNËS

VENDIMI 01-Nr. 400-51039 të datës 27/08/2018

GRUPI PUNUES - KOMISIONI PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR PËR BANIM:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Drejtoria	Përgjegjësia në Komision
1	Lumturije Kiqina	DSHMS	Kryesues
2	Gani Halilaj	Drejtoria e Urbanizmit	Anëtar
3	Halim Prokshi	Drejtoria e Pronës dhe Kadastrit	Anëtar
4	Ahmet Ahmeti	Drejtoria për Ekonomi	Anëtar
5	Afije Veseli	Zyra për kthim dhe Komunitete	Anëtar

Ky program është realizuar me ndihmën e projektit “Banimi për të gjithë” si pjesë projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) implementuar nga OJQ Developing Together. Përmbytja e këtij botimi është përgjegjësi e Developing Together dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Komisioni Komunal i angazhuar në realizimin e programit falënderon DT’në në ndihmën e dhënë.

Përmbajtja

HYRJE.....	5
QËLLIMI I PROGRAMIT	5
OBJEKTIVI	6
SYNIMI	6
KORNIZA LIGJORE	6
DOKUMENTET TJERA RELEVANTE DOKUMENTET TJERA RELEVANTE	7
- Plani Zhvillimor Komunal (2008 – 2020+).....	7
PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT	7
VENDIMET SHITESË PËR PËRPILIM TË PROGRAMIT	8
STRATEGJITË E NIVELIT QEVERTAR.....	8
PROFILI I KOMUNËS SË DRENASIT.....	9
POZITA GJEOGRAFIKE	9
KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE DHE POPULLSIA E DRENASIT	10
LËVIZJA E POPULLSISË	13
MIGRIMI	14
SHTIMI NATYROR	14
JETËGJATËSIA.....	14
ARSIMI	15
BANIMI	15
ANALIZË EKONOMIKE.....	17
BUJQËSIA	19
PUNËSIMI.....	21
BUXHETI DRENASIT / POTENCIALI I KOMUNES.....	23
OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL.....	24
ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL	24
OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL	24
FAMILJET MOMENTALISHT TE NDIHMUARA ME BANIM SOCIAL.....	25
KËRKESAT AKTUALE PËR BANIM SOCIAL.....	27
KATEGORITË E SYNUARA.....	28

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË	29
GJENDJA FAKTIKE – ANALIZA NË FORMË TABELARE	29
PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL	31
O1. SIGURIMI I BANIMIT PËR 5 FAMILJE	32
Banesat e ndërtuara nga Qeveria (MMPH, MPMS) blloqet e banimit Social dhe donatorët të cilat jepen me qira	32
Bonus Banimi	33
Banesat në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për Banim Social	33
Banimi individual	33
PLANIFIKIMI BUXHETOR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT	34
ANALIZA E FAKTEVE – PËRMBLEDHJE	35
REZULTATET PAS ZBATIMIT	38
O2 THEMELIMI I SEKTORIT TE BANIMIT	38
Instrumentet e mbikëqyrjes	39
Instrumentet e garantimit të realizueshmërisë së programeve	39
ANALIZA SWOT	40
OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TREVJEÇAR TE BANIMIT (PËRMBLEDHJE).....	411
PËFUNDIMI.....	44

HYRJE

Komuna e Drenasit deri më tani nuk e ka hartuar Programin Trevjeçar për Banim prandaj me vendim të kryetarit të komunës, ka formuar Komisionin Komunal për hartimin e Programit Trevjeçar për periudhën 2019-2021. Banimi dhe sigurimi i çështjes së banimit të qytetarëve është obligim i komunës. Pra, komuna e Drenasit duhet të merret me sigurimin e banimit për ata qytetarë të cilët nuk kanë mundësi për sigurim të kulmit mbi kokë për vete dhe për familjet e tyre. Banimi është çështje vendimtare për një stabilitet social, shëndet të mire dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies sociale njerëzore. Vlen të theksohet se e drejta e banimit është njëra ndër të drejtat elementare të njeriut që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut si dhe me Kartën Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Banimi luan rol kryesor në krijimin e hapësirave ku njerëzit dëshirojnë të jetojnë, ku dëshirojnë të investojnë dhe të kalojnë jetën e tyre.

Me miratimin e Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Nr. 03/L-164, ofrohet një kornizë më e avancuar për autoritetet vendimmarrëse lokale, duke ofruar banim të qëndrueshëm për popullatën në territorin e komunave të Republikës së Kosovës. Edhe komuna e Drenasit në programet e saj zhvillimore ka për qëllim përmirësimin e banimit social për qytetarët e saj, pasi deri me tash, pos investimeve për ndihmë në ndërtim të disa shtëpive, apo riparimeve, nga aspekti i qëndrueshmërisë për banim social, nuk ka pas ndonjë program te tillë.

Hartimi i Programit për banim social 2019-2021, do të mundëson kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për ato familje të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit dhe me forca vetanake e kanë vështirë të e bëjnë një gjë të tillë.

Ky dokument, pra Programi Trevjeçar për Banim social, do të mundësojë trajtimin e çështjeve kyçe të identifikuar, siç janë mungesa e banimit adekuat, përkeqësimi i banimit ekzistues, etj. Pas këtij programi me punën tone aktive priten të bëhen ndryshime dhe do të krijohet baza ligjore për zgjidhje më të qëndrueshme.

QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi trevjeçar i banimit social në komunën e Drenasit ka për qëllim identifikimin e rasteve dhe ndihmën për sigurimin e banimit për kategori të ndryshme të qytetarëve të kësaj komune për zgjidhjen e problemit të banimit. Po ashtu qëllim tjetër është edhe krijimi i kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me normat dhe standardet evropiane të banimit. Po ashtu në kuadër të këtij

programi parashihet krijimi i një departamenti të veçantë për banim i cili do të trajton çështjen e banimit social dhe të mirëmbajtjes së ndërtesave në bashkëpronësi në mënyrë më efikase.

Ky program po ashtu do të mundëson zhvillimin e politikave adekuate dhe zbatimin e tyre me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për kategori të caktuara të cilat nuk kanë fuqi ekonomike që të zgjidhin problemin e banimit.

Ky dokument është pagatitur në përputhje me Kornizën Ligjore nga fusha e banimit dhe udhëzuesit për hartimin e programeve trevjeçare komunale, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-164, për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.

OBJEKTIVI

Përmirësimi i jetës së qytetarëve të komunës së Drenasit dhe sigurimi i një pjese të qytetarëve banimi është objektivi kryesor, si dhe reduktimi i këtyre familjeve që nuk kanë kulm mbi kokë. Planifikimi dhe shfrytëzimi i mjeteve financiare për zhvillimin e banimit social dhe përmirësimi i vazhdueshëm i nivelit të jetës të qytetarëve, që mos të kanë problem të banimit, është dhe do të jetë objektivi primar.

SYNIMI

Hartimi i këtij programi për banim social do të mundësojë që të konkurrojmë si komunë në ndonjë projekt i cili lidhet me banim social në mënyrë që të krijohen kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit. Pra synimi është që të u mundësohet zgjidhja e nevojave të kategorive të caktuara të cilat nuk kanë mundësi të zgjidhin problemin e banimit me forca vetanake.

Me hartimin e këtij Programi trevjeçar synojmë plotësimin e obligimeve ligjore, e që hartimi dhe zbatimi i këtyre politikave të banimit në Komunën e Drenasit të ndërlidhet me procesin e integritetit evropian dhe me kriteret për anëtarësim në BE duke respektuar Konventat Evropiane, Kartën Sociale Evropiane dhe Deklaratën për të Drejtat e Njeriut.

KORNIZA LIGJORE

Programi Tre-Vjeçar për Banim është bazuar në legjislaturën si në vijim:


- Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit;
- Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e Kontratës për banesën me qira jo profitabile;
- Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e bonusit të banimit;
- Udhëzimi Administrativ për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit;
- Udhëzimi Administrativ për normat e banimit për programet e veçanta të banimit;
- Udhëzimi Administrativ për procedurat e shpalljes të programeve të veçanta të banimit;
- Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit;

- Ligji për shfrytëzimin administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi;
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Ligji nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore;
- Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit;
- Statuti i Komunës;
- Dokumentet planore – urbane;
- Ligji për Procedurat Administrative;

DOKUMENTET TJERA RELEVANTE DOKUMENTET TJERA RELEVANTE

- Programi dhe Udhëzuesi për Banim Social / Dhjetor 2007
- Statuti i Komunës Nr. 01-1106904 datë 24/09/2008
- Plani Zhvillimor Komunal (2008 – 2020+)
- Plani Zhvillimor Urban (2008 – 2020+)
- Plani Rregullues Urban Lagjeve të Drenasit, Lagjëve/Qendra 1 Vendimi Nr.01-351-10662 dt.24.02.2012; Qendra 2 Vendimi nr.310-10678 dt. 24.07.2012; Qendra 3 Vendimi nr.012-355-10679 dt.24.07.2012; Poklek 3 Vendimi Nr.350-106820 datë 24.07.2018 dhe Plani Rregullues për Lagjen e Dëshmorëve Poklek i Ri, Vendimi Nr.031-883 dt.18.01.2010
- Ligji për Procedurat Administrative 05/L-031

PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT



VENDIMET SHITESË PËR PËRPILIM TË PROGRAMIT

Vendimet shitesë për përpilim të Programit Trevjeçar për Banim janë si në vijim:

- Vendimi i Kryetarit të Komunës së Drenasit datë 27.08.2018, për përgatitjen e Projektit të Programit të Veçantë për Banim në Komunën e Drenasit për Periudhën 2019-2021
- Sigurimi i të dhënave nga fushat përkatëse të Komunës (Drejtoria e Arsimit, Qendra për Punë Sociale, Zyra për Komunitete, Qendra për Punësim etj)
- Identifikimi i grupeve të synuara
- Kategorizimi i grupeve dhe klasifikimi i kërkesave për përcaktimin e radhës së përparësisë (UA Nr.21/2010) për gjendjen faktike të çështjes së banimit
- Struktura e Buxhetit Komunal në Drenas
- Përgatitja e dokumentit
- Bërja publike e PTB (Programit Trevjeçar të Banimit) – informimi
- Procedurat e miratimit të dokumentit,
- Aprovimi nga Kuvendi i Komunës

Në përpilim të programit ka ndihmuar edhe OJQ Developing Together.

STRATEGJITË E NIVELIT QEVERITAR

- Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në RK 2009- 2015 dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së RK për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas, 2009-2015
- Strategjia Kombëtare për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar, Plani i Veprimit dhe Rregullorja nr. 20/2012 për menaxhimin e programit, organet kompetente, procedurat dhe kriteret e përfitimit për ri-integrimin e personave të riatdhesuara
- Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2014-2018 dhe Plani i veprimit për strategjinë për komunitet dhe kthim 2014 – 2016.

PROFILI I KOMUNËS SË DRENASIT

Informata të përgjithshme për komunën e Drenasit janë të përshkruara në vijim:

POZITA GJEORAFIKE

Komuna e Drenasit (Glllogocit) është themeluar para Luftës së Dytë Botërore si njësi sociale, politike dhe administrative e veçantë. Gjatë tetëdhjet viteve të fundit, zhvillimi ekonomik ka qenë tepër i ultë sepse pushtetet antipopullore të këtyre periudhave kanë ndjekur politikë specifike diskriminuese në çdo sferë të jetës.

Komuna e Drenasit shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës me një pozitë shumë të mirë gjeografike – teritor ndërlidhës, gjë që i mundëson kësaj të jetë më afër qendrave tregtare, industriale, qyteteve tjera të Kosovës dhe Kryeqytetit Prishtinës.

Hekurudha Prishtinë-Fushë Kosovë-Pejë/Prizren, Autostrada Shqipëri-Prizren-Prishtinë-Merdare, pastaj Maxhistrallja Arllat-Pejë, Mitrovicë-Skenderaj-Drenas-Komoran dhe Rruga Regjionale Komoran-Carralevë, i mundësojnë Komunës së Drenasit qasje ideale me të gjithë koridorët lokal, regjional dhe ndërkombëtar duke mos anasjkaluar edhe Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” 17 km nga Drenasi që i ofrojnë Drenasit parakushte për zhvillim.

Komuna e Drenasit kufizohet:

- Në jug-lindje kufizohet me teritorin e Komunës së Lipjanit.
- Në Lindje me teritorin e Komunës së Fushë Kosovës dhe Obiliqit.
- Në Veri-Lindje kufizohet me teritorin e Komunës së Vushtrisë,
- Në Veri me teritorin e Skenderajt,
- Në perëndim me teritorin e Komunës së Klinës dhe
- Në Jug-perëndim me teritorin e Komunës së Malishevës.

Zhvillimi i hovshëm i infrastrukturës rrugore dhe konsolidimi i qeverisjes lokale në Komunën e Drenasit, i ka dhënë prioritet zhvillimit ekonomik-zhvillimit të sektorit privat, krijimit të lehtësirave për investime vendore dhe të huaja etj, përmirësimit të mjedisit dhe kushteve të jetesës të banorë-qytetarëve të vet.

Komuna e Drenasit gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, përafërsisht 32 km nga Prishtina, 270 km nga Tirana, 17 km nga Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari”

Komuna e Drenasit është një nga dy qendrat më të rëndësishme administrative të cilat shtrihen në rrafshnaltën e Drenicës dhe ka një sipërfaqe prej 275.6 km². Teritori i Komunës së Drenasit gjindet gjithashtu në mes të rrafshin të Kosovës dhe Dukagjinit duke paraqitë një teritor ndërlidhës shumë të rëndësishëm. Në pjesën Veri-Lindore kemi malin e Qyqavicës me një lartësi mbidetare 1.091 m pastaj majën e Gospojës dhe Goleshit me një lartësi 1.019 m (malet e Blinajës), kurse në Jug-Perëndim gjendjen vargmalet e Drenicës (Berishës) dhe Kosmaqit me një lartësi mbidetare prej 979m.

Ndërsa Kodi Postar është 13000.




Figura 1. Pozita gjeografike e Drenasit

KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE DHE POPULLSIA E DRENASIT

Lëvizjet demografike në komunën e Drenasit nuk dallojnë shumë nga trendet mesatare në nivel të Kosovës. Dendësia banimore ndryshon nga njëri vendbanim në tjetrin, duke arritur vlera më të larta në vendbanimet e ulëta përgjatë vijave kryesore rrugore, sidomos në qytetin e Drenasit si qendër komunale.

Bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë në vitin 2011, pra regjistrimi e fundit që është bërë në Kosovë, del se Drenasi ka gjithsejtë 58.531 banorë rezident, dhe afërsisht 15.000 banorë jo rezident. Vendbanimi kryesor i Komunës është qyteti i Drenasit me 7210 banorë, ndërsa pjesa tjetër jetojnë në vendet rurale të kësaj komune në gjithsej 42 vendbanime me 42938 banorë.

Sipas këtij regjistrimi, Komuna e Drenasit ka 14859 banesa (shtëpi) dhe 11787 ekonomi familjare. Të banuara janë 78.1% (9,206), kurse të pa banuara 21.9% (2,581).

Dy të tretat e teritorit të Komunës janë pjesë rrafshinore. Rrafshi i komunës e sidomos lugina e lumit "Drenica" dhe lumit Verboc-it është tokë me potenciale për zhvillim të agro-industriës duke pasqyruar edhe sistemin e ujitjes "Ibër-Lepenc" konsiderohet rrjeti kryesor hidrografik i saj.

Dendësia e popullsisë në komunën e Drenas, është 212.22 banorë në km. katror.

Drenasi ka klimë kontinentale me të reshura mesatare gjatë vitit.

Nr	Subjekti		Të dhënat Statistikore		Shenime
1	Sipëfaqja		275.8 Km ²		212.22 Banor/km ²
2	Nr.Popullsisë		58,531 banorë		Regjistrimi/2011
3	Nr.Popullsisë jo-rezidente e pëafërt		15,000 banorë		24%
4	Vendbanimi kryesorë – Drenasi (I,II,III)		8,148 banorë		/
5	Nr.Vendbanimeve		42 vendbanime		/
6	Dendësia Mesatare		212		212.22 km/2
7	Ekonomitë Familjare	Gjithsej:	11,787	100%	/
		Të Banuara	9,206	78.1 %	/
		Të Pabanuara	2,581	21.9 %	/
8	Dy të tretat e teritorit të Komunës		Pjesë rrafshinore		183.8 km/2
9	Rrafshi i Komunës e sidomos lugina përgjat lumit “Drenica”		Tokë me potenciale të mundëshme për zhvillimin e bujqësisë intensive dhe zhvillim të agro-industrisë		/
10	Lumi “Drenica”, kanali i sistemit “Ibër-Lepenc” si dhe lumi Verbofc		Konsiderohet të jenë rrjeti kryesor Hidrografik i Komunës		/

Tabela 1 Shënime të përgjithshme për Drenasin

Nr. R.	Vendbanimi	Banorë			Nr.R	Vendbanimi	Banorë			Nr.	Vendbanimi	Banorë		
		Gj	M	F			GJ	M	F			GJ	M	F
1	Drenasi / U	6122	3,013	3104	16	Gjergjiçë				31	Poklek i Ri			
2	Drenasi II/ U				17	Gll'obar	1,526	795	731	32	Polluzhë	1,017	506	511
3	Çikatovë e Re / U	2,026	1,016	1,010	18	Gllanasellë	1,591	789	802	33	Sankoc	1,437	749	688
4	Komoranil/L.Re/ U				19	Godanc	358	197	161	34	Shtnubullovë	1,102	547	555
5	L.Dëshmorë /Poklek Ri/U				20	Gradicë	842	430	412	35	Shtuticë	934	471	463
6	Lagja Feronikelit / U				21	Kishnarekë	1,504	787	717	36	Tërstenik	3,903	2,024	1,879
7	Abri e Epërme	1,776	915	861	22	Komoran	4,393	2,242	2,151	37	Tërdec	1,121	588	533
8	Arlilat	3,134	1,569	1,565	23	Korroticë/L	1,240	634	606	38	Vasilevë	634	316	318
9	Baicë	2,307	1,202	1,105	24	Korroticë/U	972	507	465	39	Verboc	1,247	633	614
10	L.Bytyqëve				25	Krajkovë	1,181	601	580	40	Vuçak	369	180	189
11	Çikatovë Vjetër	1,261	625	636	26	Likoshan	1,261	625	636	41	ZabelEpërm	565	295	270
12	Damanek	706	346	360	27	Llapushnik	3,433	1,718	1,715	42	Zabeli Ultë	1,077	539	538
13	Dobroshec	1,457	773	684	28	Negroc	1,540	771	769					
14	Fushticë / Ep	984	531	453	29	Nekoc	3,118	1,578	1,540					
15	Fushticë / P	1,066	535	531	30	Poklek i Vjetër	1,967	987	980					

Tabela 2. Të dhëna lidhur me vendbanimet e Komunës së Drenasit (sipas regjistrimit 2011, 35 vendregjistrime e gjithsej 42 vendbanime.

LËVIZJA E POPULLSISË

Sa i përket lëvizjeve natyrore të numrit popullatës, komuna e Drenasit nuk dallon shumë nga mesataret në nivel të Kosovës. Sipas të dhënave të Raportit të DSHMS të vitit /2006 (të dhënat krahasuese 2003 deri 2006) në Maternitetin e QKMF-së Drenas në vitin 2003 ka pasë 747 lindje (tri lindje bineç, dy lindje me bebe të vdekura), në vitin 2004 lindje janë 648 (një lindje bineç, një bebe lindur e vdekur), Viti 2005 shenohet me 543 lindje (1 lindje bineç, një lindje me bebe të vdekur) dhe vitin 2006 ka pasë 525 lindje (dy lindje bineç, dy lindje me bebe të vdekura). Raporti i fundit i DSHMS i vitit 2017 na jep të dhëna se në maternitetin tonë ka pasë 130 lindje, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 janë 53 lindje. Lëvizja mekanike e popullsisë / **Migrimi**, Shpopullimi është mjaftë i theksuar edhe në komunën e Drenasit, sidomos në vendbanimet kodrinore – malore, si pasojë e kushteve jo të mira. **Shpopullimi** më i shfaqur është për shkak të koncentrimit më të madh të veprimtarive ekonomike, industriale dhe shumë veprimtarive tjera, dinamikën më të lartë të ardhjes e ka vetë qyteti i Drenasit. Përpos migrimit brenda Kosovës dhe në qendrën komunale, mjaft i theksuar është edhe migrimi i popullatës jashtë Kosovës. Zhvillimi i ngadalshëm ekonomik, pamundësia për të siguruar punë.

Drenasi / Përbërja etnike sipas Regjistrimit të vitit 2011										
Viti 2011 / Etnia	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Shqiptar	Turk	Serbë	Boshnjak	Egjiptian	Të Tjerë	Preferoj të mos përgjigjem
Rexhistrimi / 2011	58,531	29,728	28,803	58,445	5	2	14	2	22	3

Tabela 3: Struktura Etnike - Komuna e Drenasit sipas regjistrimit 2011¹

¹ Enti Statistikave të Kosovës / Rexhistrimi i Popullsisë 2011,

MIGRIMI

Në raport me popullsinë rezidente, Drenasi ka edhe popullsinë që ka shkuar jashtë vendit rreth 24 %. Dhe në qoftë se e llogarisim këtë përqindje në kuptimin më konkret, del që gati çdo i dyti banorë i Drenasit në krahasim me popullsinë rezidente, ka dalë jashtë Komunës së Drenasit. Emigrimi më i madh jashtë vendit, ka ndodhur gjatë viteve 1990-1998 para luftës në Kosovë. Pas vitit 1999/2000 ka vazhduar emigrimi në numër më të vogël si pasojë e kushteve shkatërruese të luftës rreth 90% djegëje të objekteve të banimit. Trendi i migrimit në Komunën e Drenas-it vazhdon edhe sot ku një numër i të rinjve po emigrojnë për shkak të kushteve ekonomike dhe për të siguruar një vend pune.

SHTIMI NATYROR

Bazuar në raportet e DSHMS si dhe (Shërbimi i Ofiqarisë) pranë komunës së Drenasit, ka bërë të ditur se numri i lindjeve pra shtimi natyror në këtë komunë është në rënie. Rënia e lindshmërisë është si pasojë e zhvillimit ekonomik të ngadalshëm por edhe nga planifikimi më i mirë i familjeve. Keshtu sipas Raportit DSHMS (shërbimit të ofiqarise) derisa në vitin 2003 kishte gjithsejtë 747 lindje, në fund të gjashtëmujorit të parë 2018 ka pasë 53 lindje.

JETËGJATËSIA

Jetëgjatësia, është një prej treguesve të rëndësishëm sepse ka të bëjë me përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve dhe përkujdesjes më të mirë shëndetësore pastaj standardit të përmirësuar, ushqimit më adekuat etj. Nga këto të dhëna llogaritet treguesi i jetëgjatësisë. Jetëgjatësia në komunën e Drenasit mesatarisht është 69 (M)-71(F) vite, mesatarisht e përafërt me jetëgjatësinë në Kosovë.

ARSIMI

Sistemi edukativo-arsimor në komunën e Drenasit është i organizuar dhe funksionon në tri nivele.

- Arsimi parashkollor;
- Arsimi fillor;
- Arsimi i mesëm;

Në arsimimin parashkollor, kemi një (1) çerdhe Drenas e cila përfshinë përafërsisht rreth 150 fëmijë, në paralelet parashkollore i kemi 49, në Drenas gjithashtu funksionojnë edhe dy (2) çerdhe private (nuk kemi shënime për fëmijët e përfshirë në këto çerdhe).

Arsimi fillor organizohet në 30 shkollat fillore dhe në 2 të mesme ku janë të përfshirë 13150 nxënës, ndërsa në procesin edukativo-arsimor janë të angazhuar 958 të punësuar, prej tyre 765 mësimdhënës dhe 49 edukatorë.

BANIMI

Banimi, si funksion kryesor i çdo vendbanimi është vendimtar për stabilitetin social, mjedis të shëndoshë, shëndet të mirë dhe për një mirëqenie njerëzore në përgjithësi.

Banimi duke qenë shfrytëzuesi më i madh i hapësirës, si aktiviteti themelor i vendbanimeve, ai ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithëmbarshtëm të shoqërisë dhe është komponentë e rëndësishme e zhvillimit ekonomiko-social, përkatësisht të standardit jetësor të qytetarëve në përgjithësi. Zona urbane e qytetit të Drenasit karakterizohet me dendësi më të lartë se zonat rurale dhe kjo dendësi është rreth 212.22 banorë/ha. Kjo dendësi është më e lartë se në zonat rurale.

Vjetërsia, kualiteti dhe funksionaliteti i fondit ekzistues banesor, përcakton edhe jetëgjatësinë e ndërtesave të caktuara si dhe fondit banesorë në Drenas në përgjithësi.

Bazuar në PGJU-në deri në vitin 2000 është dashur të kryhet ndërrimi i përgjithshëm i fondit të vjetërsuar banesor nga materialet e dobëta të ndërtuara para vitit 1960 dhe një pjesë e banesave të ndërtuara nga viti 1960/65 deri në vitet 1980-ta. Përveç kësaj pas rikonstruktimit të qytetit dhe ndërtimit të objekteve të reja para së gjithash në zonën qendrore të qytetit të viteve 1980-ta. Banesat për shkak të ndikimit të tyre në nr. e popullsisë, kushtet e jetesës, dhe veçanërisht hapësirës të cilën e marrin në kuadër të planit gjeneral urbanistik përbëjnë një ndër komponentët më të rëndësishme strukturës urbane dhe zhvillimit të politikave hapësinore të çdo vendbanimi, si dhe të qytetit Drenasit.

Banimi si fenomen dhe funksionit i përket rajonit me zhvillim ekonomik dhe social më të avancuar, kështu që këto dy aspekte janë të rëndësishme për zhvillim urbanistik dhe hapësinor të vendbanimit. Procesi i ndërtimit, rikonstruktimit dhe modernizimi të fondit të banesave i përket funksionit prodhues të hapësirës banuese, derisa në anën tjetër në kuadër të kërkesave në rritje të qytetarëve, nevoja për banim radhitet menjëherë pas ushqimit dhe veshmbathjes, kjo gjë rritë parametrat e zhvillimi social.

Hapësira e banimit nëpër qytete variron 60-70% në strukturën e përgjithshme të territorit të përfshirë në planin gjeneral urbanistik, derisa shpenzimet e ndërtimit të vendbanimeve variojnë në proporcion 50-70% të shpenzimeve të tërësishme në ndërtimin e qytetit, duke mos llogaritur objektet ekonomike. Prandaj problematika e banimit zë vend të posaçëm në planet për zhvillimet e ardhshme të zonës urbane.

Faktorët themelor që ndikojnë në kërkesat për banim:

Rritja e popullsisë dhe të amvisërive si dhe ndryshimet në strukturat e tyre, si ngritja të fuqisë ekonomike të qytetit (Drenasit) kushtëzon nevojën e ndërtimit të një numri më të madh të banesave duke pasqyruar bazën ndryshimi standardit dhe mënyrës jetësore. Nga ana tjetër vetëkushtëzohet nevoja për organizimin e hapësirës adekuate, e cila kërkohet nga planet urbane, avancimi i strukturës së hapësirës si dhe zgjedhja më e mirë e tereneve të parapara për ndërtim banesor.

Karakteristikë e fondit ekzistues të banimit si dhe mangësitë në mënyrën dhe standardin e banimit, në të ardhmen duhet të eliminoheshin sepse kushtëzonin definimin si dhe harmonizimin e disa faktorëve nga të cilët do varej vëllimi dhe kualiteti i ndërtimeve banesore në të ardhmen që janë:

- Zhvillimi ekonomiko-shoqëror i komunës dhe qytetit, gjë që i përcaktonte kornizat materiale të ndërtimit banesor;
- Rritja e strukturës së popullsisë dhe të amvisërive në qytet që do të paraprinte rritjes natyrale të migrimit nga vendbanimet rurale;
- Vëllimi i strukturës të fondit ekzistues banesor i cili do të mbetej në shfrytëzim pas zbritjes së banesave të caktuara të cilat do të rrënoheshin për shkak të vjetërsisë (amortizimit) si dhe rikonstruktimit të qytetit.

Qëllimet të cilat ishin parapara të arriheshin në përmirësimin e standardit të banimit deri në fund të periudhës për të cilën ishte punuar plani.

* PGJU-ja parashihte që rajoni i vendbanimit Drenasit edhe në të ardhmen do të ishte vend i theksuar i migrimit, i cili do të ketë ndikim në përqindjen e madhësisë së amvisërive.

* Projektioni i amvisërive bazohej në projektionin e përqindjes së madhësisë së amvisërive dhe numrit të banorëve. Me rënien e mesatares së amvisërive parashihej një ndryshim i dukshëm në zvogëlimin relativ të pjesëmarrjes të amvisërive të mëdha, respektivisht rritjen e pjesëmarrjes me anëtarë më pak.

* Amvisëritë me 2,3,4 dhe 5 anëtarë, do të rrisnin pjesëmarrjen e tyre, në krahasim me vitet e kaluara (1981). Amvisëritë me 6,7,8 dhe më shumë anëtarë do të zvogëloheshin, derisa ato absolute edhe me tej do të rriten. Posaçërisht e lartë ishte pjesëmarrja e amvisërive me 8 dhe më shumë anëtarë në rritje nga 33,7 % (1971) në 36,2% (1981). Përkundër planifikimit për zvoglim, deri në vitin 2000 kjo përqindje do të mbetet e lartë.

Periudha e pas luftës

Në vitet e pasluftës si pasojë e migrimit të banorëve nga zonat rurale si dhe përpjestimeve falijare, është shënuar rritje e numrit të njësisve banesore e cila fatkeqësisht nuk ka mundur të përcillet krahas me rritjen e kapaciteteve të shërbimeve dhe të infrastrukturës.

Lufta e fundit, në Drenas, përveç tjerash, la pasojat të dukshme edhe në fondin banesor. Edhe pse faza e rindërtimit emergjent ka përfunduar, pasojat e luftës ende nuk janë eliminuar tërësisht. Nevojat për përmirësim të kushteve të banimit, qoftë drejtpërdrejtë në objektet e banimit apo të shërbimeve që ndikojnë në cilësinë e banimit, janë ende të dukshme.

Ndryshimet dinamike sociale dhe ekonomike të pasluftës e sidomos migrimet drejt zonës urbane si dhe përpjestimet familjare, kanë reflektuar edhe në zhvillimin jo të balancuar të banimit. Deri sa në Drenas si qendër urbane kemi një rritje të dendësisë, ndërsa në shumë fshatra, sidomos në ato më të pazhvilluara

malore dhe rurale kemi një shpopullim të vazhdueshëm. Kjo lëvizje e banorëve ka për pasojë uljen e cilësisë së banimit në qytet për shkak të rritjes së numrit të banorëve në raport me shërbimet dhe kapacitetet ekzistuese. Ndërkaq në fshatra vie deri te mosshfrytëzimi i kapaciteteve të banimit dhe rrjedhimisht mungesës së investimeve në kuptimin e përmirësimit të kushteve të jetesës në fshat. I tërë ky zhvillim jo i balancuar shkakton vështirësi dhe mund të krijojë pasoja edhe në zhvillim të përgjithshëm social dhe ekonomik në qytet dhe në komunën e Drenasit, sidomos, nëse merren parasysh potencialet natyrore për zhvillim të bujqësisë, pemtarisë dhe blegtorisë.

Roli i ri i qeverisë lokale në menaxhimin e problemeve urbane si dhe mungesa e legjislacionit krijuan hapësirë për një hov ndërtimesh të pakontrolluara sidomos në fondin e banesave pa pasur të qartë fenomenet e lartëshenuara dhe nevojën e tregut. Projektet e ndërtimit të komplekseve të banimit që bënte sistemi i kaluar, tanimë bëhet e pamundur në mungesë fondesh dhe paqartësishë në menaxhimin e tokës-pronës komunale.

Tanimë do t'i hapet rruga ndërtimeve dhe iniciativave individuale, të cilat komuna, me vështirësi po i menaxhon. Të dhënat e dala nga hulumtimet në terren, të parqitura në tabelat e mëposhtme nga Drejtoria për Bujqësi e Zhvillim Rural, është e analizuar kjo çështje dhe del në pah domosdoshmëria e implementimit të këtij Programi në periudhën afatmesme dhe aftgjatë.

ANALIZË EKONOMIKE

Drenasi, zhvillimin e vet e mbështet, në resurset njerëzore e natyrore, në traditën e popullatës së kësaj ane , potencialin bujqësor, agrikulturë, blegtori, dhe pylltari.

	BPV (€)				Trendet e rritjes/ zvogelimit- viti:			
	2011	2012	2013	2017\2018	2011- 2012	2012- 2013	2013- 2018	2011- 2018
Komuna								
Kosova	6.69	6.47	7.07	7.13	-0.22	0.6	-0.06	0.44

Tabela 4. Bruto prodhimi vendor. Burimi ASK

Pronesia	Ndermarrje (nr.)			
	2011	2012	2013	2018
Private	2420	2605	2848	4028
Publike- Komunale	2	2	2	2
Publiko (Komunale)- Private	0	0	0	0
Publike- Shoqerore	6	6	6	6
Publiko (Shoqerore)- Private	0	0	0	0
Gjithsej	2428	2613	2856	4036

Tabela 5. Ndermarrjet ekonomike, sipas pronesisë, 2011- 2018

BUJQËSIA

Bujqësia është mjaft e zhvilluar në komunën e Drenasit. Disa informata specifike lidhur me bujqësinë janë dhënë në vijim:

Diagrami. Shpendaria e tokës bujqësore sipas kulturave bujqësore




Figura 2. Shpendarja e tokës bujqësore sipas kulturave bujqësore²

Lavërtaria—Drithërat si kultura bujqësore në komunën e Drenasit zë vendë shumë me rëndësi edhe pse sipërfaqet të mbjella me këto kultura janë zvogëluar dukshëm. Megjithatë në vitin 2006-07 me këto kultura janë të mbjella 4481 ha ku prin kultura e grurit, pastaj misri, tërshëra, elbi, thekra, etj. Në këto vitet e fundit ka filluar përsëri të kultivohet kultura e sojës dhe kolzës (sipërfaqe e vogël).

Në vitin 2005 ka pasur rendiment të lartë me një mesatare prej 4500 kg /hektar te kultura e grurit, ndërsa te misri ka qenë 6000 kg/hektar.

Perimkultura—Edhe kjo lëmi e bujqësisë është mjaftë e përhapur dhe e preferuar në Komunën e Drenasit. Këtë vit janë mbjellë rreth 47 ha, ku si kulturë kryesore është speci pastaj domatja, shalqiri, pjepri, qepa, etj.

Viteve të fundit ka marr hov kultivimi i perimeve në ambient të mbyllur (sera), është bërë një shtim i dukshëm i sipërfaqeve me sera. Deri më sot janë 15 hektar me sera të ndërtimeve të ndryshme, nga ai më i thjeshtë i drurit e deri te ato të modernizuara.

Pemëtaria—Komuna e Drenasit ka kushte të volitshme klimatike—tokësore shumë të favorshme për kultivimin e pemëve. Më së shumti kultivohen mollët, dardhat, kumbullat, qershitë, pjeshkat, kajsitë, arrat dhe gështenjat 112 ha.

Kjo veprimtari ka filluar të ringjallet dhe në rritjen e sipërfaqeve.

² Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Blegtorisë dhe Pylltarisë, Komuna e Drenasit, Prill 2007

Në ekonomitë familjare ngritja e kopshteve me pemë ka marr hov shumë të madh dhe sot kemi të ngritura mbi 112 ha me lloje të ndryshme të pemëve në oborre dhe kopshte të shtëpive dhe arave.

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, Blegtorisë dhe Pylltarisë, Komuna Drenasit, Prill 2007-2018

Shpeztaria—Mbajtja e shpendëve është mjaft e përhapur në ekonomitë familjare. Gati çdo familje posedon një sasi të vogël të shpendëve, që kryesisht shfrytëzohen për nevojat familjare. Para lufte kanë qenë 4 mini ferma për mbajtje të shpezëve (me kapacitet 3000-4000 krerë), të cilat u dëmtuan rëndë. Sipas të dhënave të fundit 2007-2008 nga DBBP numri i përgjithshëm i fondit të shpezëve në komunën e Drenasit arrin 110304 shpezë.


Blegtoria—Sipërfaqja poseduese e livadheve, terreni i përshtatshëm për kullosa si dhe interesimi i vazhdueshëm i fermerëve për blegtorinë dhe shpeztarinë janë potenciale të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe zbutjen e problemeve sociale në fshatra. Para luftës fondi i bagëtive ka qenë i pasur me gjedh (rreth 15,234 krerë). Gjatë luftës ky fond u përgjysmua dhe kap shifrën prej 7943 krerë lope qumështore.

Sipas të dhënave të fundit (2014) nga Drejtoria për Bujqësi, Blegtori dhe Pylltari, KKS numri i përgjithshëm i gjedhëve, viçave dhe mështjerrave është 12,071.

Bletaria—Drenasi ka kushte të përshtatshme për zhvillimin e bletarisë, mbasi ka shumë livadhe me lule, drurë akacie, si dhe një ambient ekologjikisht të pastër nëpër pyje. Këtë vit është formuar 'Shoqata e Bletarëve', e cila po ndihmon zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë së fermerëve /apo bujqve në fushën e bletarisë. Aktualisht në territorin e Drenasit ekzistojnë 3594 koshere bletësh (viti 2014).

Teknikat bujqësore - për lëvrimin e tokës, mbjelljet, korrjet dhe shirjet, spërkatjen e kulturave bujqësore, si dhe punëve të tjera në bujqësi përdoren traktorët (kryesisht tipi 539 IMT), rimorkio, plugje, freza, autokombajna dhe vegla e makineri të tjera bujqësore. Megjithatë është e domosdoshëm që ky sektor të modernizohet më tej nëpërmjet futjes në përdorim të makinerive dhe teknologjive të reja si ato për mbjelljet e bimëve, spërkatjen dhe vjeljen e pemëve.

Sipas të dhënave të fundit (2014) nga Drejtoria për Bujqësi, Blegtori dhe Pylltari, në komunën e Drenasit ekzistojnë 11.787 ekonomi familjare që jetojnë nga bujqësia. Nëse kalkulohe me numrin mesatar të anëtarëve të familjes do të jenë përafërsisht 23.500 banorë që merren me bujqësi..



PUNËSIMI

Komuna e Drenasit, më heret kishte një ekonomi fillimisht në zhvillim e sipër dhe hynte në mesin e atyre komunave me një fabrikë prodhuese "Feronikeli" 1980 dhe Organizata Bujqësore Industriale "Agroprodukti" në mesin e tyre kishin të punësuar mbi 1500 deri 2000 punëtor, por kjo ishte deri nga fundi i viteve 80-ta. Pas këtyre ishin edhe disa organizata tjera punuese mjaft rentabile, si "Ndërtimari" etj. Por me hyrjen e masave të përkohshme nga ana e regjimit serb pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës, këto organizata u shkatërruan, u vodhën dhe humben prestigjin, pasi u larguan nga puna e gjithë fuqia punëtore shqiptare. Edhe pas luftës me privatizimin e këtyre organizatave, nuk u arrit që ato të konsolidohen, andaj afaristet e tyre nuk mundën të i përmbushin kriteret për rritjen e numrit të punëtorëve. Vlerësohet se në sektorin shoqëror në komunën e Drenasit, janë të punësuar 1278 persona kryesisht në arsim, në administratën komunale 140 dhe në shëndetësi 181. Kurse në sektorin privat shërbeu me tabelat e lartëshenuara ekonomike (Punësimi sipas sektorëve ekonomik 2011-2018; gjithsej 6235 të punësuar sektori privat).

ASISTENCA SOCIALE / SNS Drenas (QPS)

Vitet	Numri i familjeve	Numri i antarëve të familjeve
2011	1598	7291
2012	1460	6922
2013	1491	6709
2014	1523	7156
2015	1342	6039
2016	1301	5854
2017	1223	5603

Tabela 6 Numri i familjeve që gjenden në Skemen e Asistencës Sociale

Numri i punëkërmuesve të evidentuar pranë Zyrës së Punësimit Drenas / deri më datë 18/10/2018

ppk		Ku+pmp		psp		mr		Gjithsej:	
F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
900	1280	254	365	90	104	7	8	1254	1754
2180		619		194		15		3008	

Sqarime (shkurtesat):

ppk=

punëkërkues të pakualifikuar (pa shkollë dhe me shkollë fillore

Ku+pmp=

punëkërkues me shkoll.profesionale dhe shkoll.tjera te mesme

psp=

punëkërkues me Fakultet (tre dhe katervjeçar)

mr=

punëkërkues me master dhe magjistraturë

BUXHETI DRENASIT / POTENCIALI I KOMUNES

Të dhënat tabelare lidhur me buxhetin komunal janë si më poshtë

BUXHETI I APROVUAR	2018	2019	2020	2021
1. Granti I përgjithshëm	4,638,537.00	5,384,031.00	5,861,967.00	6,235,233.00
2. Granti për Arsim	6,861,389.00	6,561,881.00	6,592,631.00	6,623,541.00
3. Granti për Shëndetësi	1,646,596.00	1,755,930.00	1,843,727.00	1,935,913.00
4. Gjithsej HVK	1,166,676.00	1,313,535.00	1,358,830.00	1,404,124.00
5. Gjithsej	14,313,198.00	15,015,377.00	15,657,155.00	16,198,811.00

Tabela 7. Buxheti i planifikuar 2019 - 2021

Bazuar në trendet zhvillimore të komunës, planifikimit të buxhetit për vitet në vijim, mund të thuhet se ndarja e buxhetit për programin e banimit kryesisht varet nga të hyrat vetanake dhe granti I përgjithshëm. Do të shikohet mundësia që nga ky buxhet në të ardhmen të ndahet një përqindje e vogël për këtë qëllim.

OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL

ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL

Në vijim do të prezantohet gjendja aktuale lidhur me objektet në pronësi të komunës të dedikuara për banim social si dhe numri/profili i familjeve tanimë të ndihmuara me banim të përkohshëm social. Po ashtu do të prezantohet kërkesa aktuale për banim në komunën e Drenasit.

OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL

Gjatë viti 2010-2011 dy ndërtesa të banimit social janë ndërtuar me donacion nga MMPH dhe MPMS, afër qytetit të Drenas konkretisht në Çikatovë të Re (Drenasi III). Objektet janë paraparë për vendosje të familjeve sociale, fëmijë pa prind dhe ata të cilët nuk kishin vendstrehim. Këto objekte janë në relativisht të mirë, por që kërkojnë mirëmbajtje të përhershme nga ana e Komunës. Përfituesit e këtyre banesave janë strehuar në bazë të kriterëve të parapara nga Komisioni i caktuar nga Kuvendi Komunal i Drenas-it, si dhe disa nga ta lokalet afariste janë shëndrruar përkohësisht në hapsira për banim të shkurtër-përkohëshëm. Një pjesë e këtyre shfrytëzuesve edhe sot e kësaj dite gjenden aty. Me këtë objekt ka menagjuar DSHMS përmes komisioneve verifikuese bazuar në Rregulloren për Banim Social 2007. Shfrytëzuesit janë me Kontrata të përkohëshme dz (2) vjeçare të shfrytëzimit. Në këto objekte janë të vendosur 50 familje (+4 familje në lokalet afariste). **Blloku I** ka 25 familje, ndërsa **Blloku II** ka 25 familje. Banorët e banimit social ndihmohen përmes DSHMS sipas kërkesave të tyre (edhe çdo muaj), pastaj përmes donacioneve të ndryshme edhe me pako higjienike, ushqimore, veshëmbathje etj.





Foto 2. Blloku Banimit Social Nr.2

FAMILJET MOMENTALISHT TE NDIHMUARA ME BANIM SOCIAL

Komuna e Drenasit për çdo vit përmes Drejtorisë Urbanizmit, në bazë të kërkesave të qytetarëve me nevojë, ndan një shumë të caktuar të mjeteve me të cilët i ndihmon familjet në nevojë për banim. Ndihma zakonisht jepet në formë të granteve të vogla për riparime të shtëpive të tyre. Pra, qytetarët ndihmohen në varësi të asaj se për çka kanë nevojë për shembull për ndërtim/riparim të kulmeve të shtëpive, vendosje të dyerve/dritareve, material tjetër ndërtimor etj. Kjo bëhet në bazë të percaktimit-vlerësimit nga ana e Komisioni i Komunal për vlerësim të banimit-strehimit. Kështu gjatë vitit 2018 për nevoja të ketyre qytetarëve nga DUPH janë ndarë nga buxheti komunal 20,000 Euro.

	Mënyra e ndihmës	Nr i familjeve të ndihmuar	Nr i individëve të ndihmuar	Data e fillimit të ndihmës	Data e skadimit të ndihmës	Vlera e qirasë/ndihma financiare (€)
1	Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;	/	/	/	/	/
2	Banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;	/	/	/	/	/
3	Banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim;	33	/	/	/	/
4	Shtëpi individuale të ndërtuara nga donatorë të huaj/vullnetarë;	Faza e rindertimiev pas luftës.	/	/	/	/
5	Renovime/riparime	2	/	/	/	
6	Ndërtime shtëpishë	0				

Tabela 8. Familjet momentalisht të ndihmuara me banim social

KËRKESAT AKTUALE PËR BANIM SOCIAL

Në tabelën e mëposhtme janë të prezantuara të dhënat lidhur me kërkesat për banim në komunën e Drenasit:

	Kategoritë	Numri i familjeve kërkues të banimit social 2017-2018
1	Me asistencë sociale	15
2	Kategoritë e dala nga lufta, familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve	/
3	Te kthyerit	0
4	Të riatdhesuarit	1
5	Te punësuarit nga buxheti shtetëror	2
6	Minoritetet	2
7	Tjerë	0

Tabela 9. Kërkesat momentale për banim

Sipas DSHMS në Drenas numri i familjeve kërkuese të banimit social në tri vitet e fundit është si në vijim:

	Me themel	Rindertim	Strehim	Rast social	Gjithsej
2016	17	27	6	/	50
2017	28	26	11	/	65
2018	36	19	23	/	78

Tabela 10. Kërkesat për banim në tre vitet e fundit

KATEGORITË E SYNUARA

Kategorizimi dhe specifikimi do të rregullohet sipas bazës ligjore duke i definuar balancën ndërmjet kategorive të synuara nëpër vite të aplikimit sipas të cilit do të përcaktohen kriteret e caktuara për familjet përfituese të cilat do të kenë për bazë: karakteristikat sociale dhe ekonomike të familjeve që presin ndihmën nga autoritetet komunale për të zgjidhur problemet e banimit.

Ndër kategoritë që do të përfitojnë nga programet e banimit parashihen :

- Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale
- Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.
- Kategoritë e dala nga lufta dhe ish të përndjekurit politik;
- Të kthyerit dhe komunitetet RAE (Minoritetet)
- Të riatdhesuarit
- Të moshuarit
- Të rinjtë
- Të punësuarit nga buxheti shtetëror
- Nënata vetushqyese-kryefamiljare

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit kriteret e përparësisë për sigurimin e banimit për kategoritë e cekura në pikën 7.1 janë:

- Statusi i banimit;
- Lartësia e të ardhurave
- Gjendja shëndetësore
- Invaliditeti
- Struktura e familjes

GJENDJA FAKTIKE – ANALIZA NË FORMË TABELARE

KOMUNA E DRENASIT			
Nr. i popullsisë		58.531	
Zonat rurale		34	
Zonat urbane		1	
Nr. i vendbanimeve (zona kadastrale)		35	
Banimi individual	Nr. objekteve para 1999		4.288
	Nr. objekteve pas 1999		7060
	Etazhiteti mesatar		P+1+NK
Banimi kolektiv	Para 1999	Nr. objekteve	6
		Nj. banimi	202
	Pas 1999	Nr. objekteve	25
		Nj. banimi	1.425
	Etazhiteti mesatar		P+7+NK
Numri i objekteve		Individuale	11348
		Kolektive	31
Raporti banim individual/banim kolektiv në [%]			90% / 10%

Kyçje në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]		90%
Nr. i objekteve të pabanuara		3886
Nr. i objekteve me vlerë kulturo historike që shfrytëzohen për banim		%
Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në [%]		48%
Ndërtimet ilegale	mbindërtimet	6
	ndërtimet tjera	14.081
	ndërtimet në pronë shoqërore	1.760
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit		78
Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit		Rruga Fatmir Isufi , S = 4-36-40 m2, parcella nr. 00326-4
Nr. i objekteve/nj. banimi e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët		2/50
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga dhe vlera mes. e qirasë		%
Nr. i objekteve/nj. banimi të disponueshëm për qira të ulëta të tregut		%
Nr. i objekteve/nj. banimi në pronësi të Komunës që duhet të rinovohen		%
Qendrat përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK	2
	Vendndodhja /emërtimi	Qikatovë e Re
	Nr. i familjeve	50
	Nr. i banorëve	229
Planet rregulluese - sa janë bërë dhe sa janë që duhet të bëhen		Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale, dhe Planet rregulluese të Hollesishme.

PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL

Programi për banim për të gjithë i Komunës së Drenasit është hartuar për periudhën 2019-2021. Komisioni i formuar nga ana e kryetarit të komunës me ndihmën e OJQ Developing Together ka bërë analizën e gjendjes ekzistuese dhe ka përgatitur propozime konkrete për të ndihmuar qytetarët e komunës së Drenasit që nuk kanë mundësi të sigurojnë kulm mbi kokë. Përpos ndihmës konkrete për qytetarët e vet, brenda kësaj periudhe tre-vjeçare do të vazhdohet me analiza për të krijuar sektorin e banimit në kuadër të komunës së Drenasit i cili i mungon komunës sonë.

Pra, Programi i prezantuar Tre-Vjeçar për Banim i ka dy objektiva:

- O1. Sigurimin e banimit për 5 familje;
- O2. Formimin e sektorit për banim;

01. SIGURIMI I BANIMIT PËR 5 FAMILJE

Prioritet kryesor i këtij programi është që në periudhën tre vjeçare komuna e Drenasit të jetë në gjendje të i ndihmojë 5 familje për tre vite, duke ju siguruar Banim Social.

Kjo do të bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për Financimin e Programeve Tre-Vjeçare për Banim. Sipas këtij ligji, sigurimi i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira, ku përfshihen:

- a) banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;
- b) banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;
- c). banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

Banesat e ndërtuara nga Qeveria (MMPH, MPMS) blloqet e banimit Social dhe donatorët të cilat jepen me qira;

Pas aprovimit të ndërtimit të këtij objekti, komuna e Drenasit zotohet se do të përpiloj një program për mirëmbajtjen e kësaj ndërtese sipas Ligjit për Ndërtesat në Bashkëpronësi (04/L – 134). Mjetet materiale për mirëmbajtje do të sigurohen nga qiraja e mbledhur në këto banesa sociale.

Bonus Banimi

Një formë tjetër me të cilën komuna e Drenasit planifikon të ndihmojë familjet në nevojë për banim social është përmes banesave ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që vlerësohen të domosdoshme për bonus të banim.

Në këtë formë Komuna e Drenasit planifikon të ndihmojë 5 familje në tre vitet e ardhshëm duke llogaritur se një familje brenda një ose dy viteve do të bëjë zgjidhje të qëndrueshme për banim.

Kjo formë e ndihmës për banim do të paguhet e tëra nga buxheti Komunal.

Vlera monetare e përafërt e kërkuar për këtë qëllim është si në vijim:

5 familje x 65 Euro/muaj x 36 muaj = 11,700 Euro

Mënyra e implementimit

Për të ndihmuar këto familje, në fillim të vitit komuna e Drenasit do të shpall konkurs. Përmes konkursit do të përzgjidhen për t'u ndihmuar 4 deri 5 familje/vit, ndërsa nga buxheti komunal për 2 familje mund të rezervohen mjetet financiare-materiale nga të hyrat vetanake dhe do të përzgjidhen për rastet ad-hoc (p.sh. dhunë në familje, djegje të shtëpisë, fatkeqësi natyrore, etj). Për këto raste do të vendosë komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Kontratat do të lëshohen dy vjeçare dhe familjet do të duhet të aplikojnë për çdo dy vite.

Banesat në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për Banim Social

Komuna e Drenasit për momentin nuk posedon ndonjë objekt i cili do të mund të renovohet.

Banimi individual

Komuna e Drenasit do të vazhdoj komunikimin me donatorë të ndryshëm të cilët janë të interesuar të ndihmojnë familjet të cilat kanë nevojë për banim që të ju ndërtohen/rinovohen shtëpi individuale. Kjo është forma më e qëndrueshme për të siguruar banimin për këto familje.

Komuna e Drenasit do të ofrojë informatat relevante dhe do të iniciojë programe në këtë drejtim.

PLANIFIKIMI BUXHETOR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

Për realizimin e Programit Tre-Vjeçar për Banim në komunën e Drenasit duhet që të bëhet planifikim buxhetor në bazë vjetore. Siç është cekur më lartë, përmes këtij programi komuna e Drenasit planifikon të ndihmojë 5 familje në vit të cilat nuk janë në gjendje që me financim vetanak të sigurojë banimin.

Nga komuna e Drenasit kërkohet që për nevoja të këtij programi në periudhën 2019-2021 të siguron buxhet në vlerë 12,000 Euro (per 5 familje). Në formë tabelare kjo ndarje duket si në vijim:

Mënyra e ndihmës	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Totali
Bonus-Banimi (pagesa e gjysmës së qirasë për familjet në nevojë për banim. Në këtë formë do të ndihmohen nga 5 familje në vit;	4,000 Euro	4,000 Euro	4,000 Euro	12,000 Euro
Totali për vite:	4,000 Euro	4,000 Euro	4,000 Euro	12,000 Euro

Tabela 10: Buxheti i planifikuar për banim social për vitet 2019-2021

Buxheti lartëshenuar është i aprovuar nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve komuna e Drenasit por do të kërkohet ndihmë edhe nga donatorë të tjerë duke përfshi edhe qeverinë e Kosovës dhe donatorë të jashtëm.

ANALIZA E FAKTEVE – PËRMBLEDHJE

1.	Qëllimi i hartimit të programit tre vjeçar	Qëllimi kryesor i përpilimit të Programit Tre-Vjeçar në komunën e Drenasit është që të ndihmohen familjet të cilat kanë nevojë për banim social e nuk kanë mundësi vetanake për të siguruar strehë mbi kokë.
2.	Baza ligjore	Ky program bazohet në legjislaturën ekzistuese të Republikës së Kosovës të përshkruar më detajisht në kapitujt e sipërm të këtij dokumenti. Sidoqoftë dy dokumentet kryesore janë Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim (03/L – 164) dhe Udhëzuesin për Hartimin e Programeve Tre-Vjeçare për Banim. Ky program mundëson një lidhje organike midis mandatit 4 vjeçar të pushtetit lokal dhe projekteve komunale në fushën e banimit. Është i paraparë afati 3 vjeçar, të jete me i përshtatshëm për të hartuar dhe për të dhënë në jetë programet e banimit, duke marrë parasysh veçoritë e komunës së Drenasit si p.sh: politikat komunale të banimit (si vecorit perkatëse), pozita gjeografike, demografike dhe institucionale.
3.	Llojete programeve të konsideruara si të nevojshme	Në këtë program do të parashihet edhe bonus banimi si një formë shumë e mirë për të ndihmuar familjet në nevojë për banim social. Në tri vitet në vijim komuna e Drenasit planifikon të ndihmojë 5 familje përmes dhënies së gjysmës së qirarë (bonus banimi).
4.	Prezantimi i gjendjes faktike	Komuna e Drenasit ka 33 objekte të banimit kolektiv të ndërtuara në pronësi të vet të cilat i ka dhënë në koncesion. Para disa viteve është cekur që janë ndërtuar dy objekte të banimit social me 50 familje në këto objekte.
5.	Kërkesat faktike për përkrahje me sigurim të banimit	A) Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi B) Familjet që nuk posedojnë sipërfaqe banimi C) Familjet që janë me kategori sociale, nënat vetushqyese D) Te riatdhësuarit, kategorit e dala nga lufta dhe komunitete.

6.	Klasifikimi i nevojave sipas urgjencës së trajtimeve të tyre	Sipas kritereve do të përcaktohen mbas ligjit nr. 03/L - 164, mbas komensionit të caktuar nga kryetari i komunes. Shpresojmë që edhe softueri për regjistrimin e përfituesve do të ndihmon shumë në këtë drejtim.
7.	Veprimet kryesore që do të ndërmerren	• Regjistrimi i aplikuesve; • Vendosija e tyre në Data Bazë; • Vizita në terren; • Krijimi i listës prioritare për ndihmë sipas mundësive buxhetore; • Nenshkrimi i kontratës me përfitues të banimit social; • Mirëmbajtja e ndërtesave në bashkëpronësi të dedikuara për Banim Social;
8.	Kohëzgjatja e realizimit të programeve	2019-2021
9.	Kornizën e shpenzimeve afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë	Për çdo vit komuna, Drenasit respektivisht përmes Drejtorisë së UPH, janë nda mjete për ndertim, rinovim të shtëpive, në baze të kërkesave të qytetarëve, pas kërkesave të tyre, ku komisioni ka bërë vlersimin.
10.	Mundësitë e kapaciteteve njerëzore dhe materiale	Planifikimi i buxhetit Donatort Zyrtar i banimit

11.	Mënyra e financimit të programeve tre vjeçare (të plotësohet më detajisht në dokumentin me programet trevjeçare të banimit)	Buxheti komunal Niveli qendror-MMPPH,MPB,MPMS,MKK Donator
12.	Përputhja e programeve me planet zhvillimore të komunës	PZHK dhe PZHU i miratuar ku janë definuar zonat e banimit
13.	Instrumentet mbikëqyrëse	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis Zyra e Kryetarit Zyrtari për banim (duhet caktuar nje zyrtar)
14.	Instrumentet e garantimit të realizimit të programeve	Monitorimin,raportet vendimet e e asambles komunaledhe programet e ndryshme te caktuara.
15.	Transparenca me hartimin dhe zbatimin e programeve	Analizë,debate publike me ekspert te ndryshëm, raportet etj.

REZULTATET PAS ZBATIMIT

Programi për Banim është hartuar në mënyrë që të mund të zbatohet, të matet dhe të monitorohet. Monitorimi është një tipar i domosdoshëm për shkak se ai siguron që veprimet janë zbatuar dhe se përpjekjet janë duke u bërë për të siguruar përshtatjen me ndryshimet në burimet e disponueshme dhe të nevojshme.

Pas përfundimit të çdo projekti në mënyrë transparente do t'i komunikohet publikut.

O2 THEMELIMI I SEKTORIT TE BANIMIT

Programi për banim i Komunës së Drenasit mbulon periudhën 2019 – 2021 Komisioni ka përgatitur propozimet për projektet prioritare zbatimi i të cilave rezulton në arritjen e Synimeve zhvillimore të përcaktuara në fushat kyçe, detyrimet akviteve, bartësit kryesor, afatin kohor të implementimit, përgatitjes dhe koordinimit të aktiviteteve të përgjithshme për implementimin e projekteve.

Në mënyrë që të sigurojë zbatimin e projekteve të planifikuara do të shqyrtohet mundësia për formimin e Sektorit të banimit i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara.

Sektori i banimit është një organ i përhershëm që do të formohet me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projekteve dhe detyrave nga Programi i banimit, si rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe mbështetjen e Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimeve që lidhen me zhvillimin e banimit dhe programet lokale që mbështesin fushën e banimit.

Ky sektor do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara për vitet në vijim. Sektori i banimit do të jetë organ i përhershëm që duhet të formohet me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projekteve dhe detyrave nga Programi i banimit.

- Rishikimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit,
- Mbështetjen e Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimeve që lidhen me zhvillimin e banimit dhe programet lokale që mbështesin fushën e banimit.

Procesi i monitorimit do të përfshijë këto aktivitete:

- Shkalla e suksesit të Programit në krahasim me Planin e Veprimit,
- Planifikimi i fondeve dhe harmonizimi i tyre në raport me afatet kohore
- Ndryshimet e mundshme të cilat mund të ndikojnë në realizimin e projekteve
- Ndryshimet e jashtme që mund të ndikojnë në Planin e Veprimit, si dhe propozimet për alternativat e zgjidhjeve të ndikuara nga faktoret tjere.

Instrumentet e mbikëqyrjes

Sektori i banimit i cili do të formohet në kuader të DPUMM, dhe me pas Agjensioni për banim, i cili do të financhet nga Komuna dhe ka për detyrë që të zhvillojë aktivitetet e mirembajtjes, implementimin e programit të banimit dhe zhvillimin e programeve tjera duke përcjelle dhe analizuar në vazhdimesisituatën e banimit.

Instrumentet e garantimit të realizueshmërisë së programeve

Burimet njerëzore:

Autoritetet kompetente :Sektori i banimit apo Agjensioni për banim që kanë për detyrë të raportojnë për të gjitha aktivitetet në fushën e banimit në çdo 6 muaj Kuvendit të Komunes.

Te përcjellin të gjitha të dhënat lidhur me mundësitë e financimit nga programet e ndryshme nacionale dhe ndërkombetare.

Te planifikojnë buxhetin krahas buxhetit komunal dhe burimeve tjera relevante nga fusha e banimit. Te përcjellin-montorojnë situatën në vazhdimësi të banorëve të cilët janë pjesë e këtyre programeve. Dhe të tjera varesisht nga zhvillimet në komunë, mundësitë e bashkëpunimit ndërkomunal për raste specifike.

Masat që janë marrë për respektimin e kuadrit ligjor

Kjo pjesë do të jetë në vazhdimësi pjesë e punës së autoriteteve komunale për të cilat do të zbatohet monitorimi dhe auditimi .

Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit të transparençës

Publiku si sovran i Komunës , do të ketë të drejtën të dijë mënyrën sesi shpenzohen të ardhurat e komunës në tërësi dhe ato të programeve tre vjeçare në veçanti e do të sigurohet duke përfshirë publikun në procesin e sigurimit të transparençës si:

- zhvillimin e takimeve konsultuese me publikun;
- bërja e anketimeve apo studimeve të ndryshme për marrjen e mendimit të publikut;
- bërjen publike të programeve dhe projekteve që përfshijnë ato
- sigurimit të pjesëmarrjes së publikut gjatë diskutimeve që organet përkatëse do të zhvillojnë për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve;
- bërjen e njoftimeve të ndryshme në mjetet e informimit publik apo në vend njoftimet komunale për aktivitetet ku mund të sigurohet pjesëmarrja e publikut
- çdo masë tjetër e cila vlerësohet e nevojshme në përmbushje të këtij qëllimi.

ANALIZA SWOT

Përparësitë	Dobësitë- Mangësitë
1. Ekzistimi i programit; 2. Ndarja e trolit; 3. Iniciativa për zgjidhjen e banimit; 4. Planifikimi buxhetor; 5. Të dhënat për nevojat e banimit; 6. Ligji për programet e veçanta të banimit; 7. Strategjia komunale 8. Interesimi i qytetarëve për pjesëmarrje në këto programe 9. Te dhenat e sakta për kerkuesit 10. Burimet njerzore të interesuar për këto Programe të veçanta	1. Lokacioni jo i përshtatshëm; 2. Mjete të pamjaftueshme buxhetore; 3. Infrastruktura përcjellëse; 4. Nuk ka person adekuat qe miret me kete pune 5. Mirëmbajtja e objekteve të banimit social 6. Mungesa e programeve të veçanta për banim social 7. Mungesa e hapsires për sherbime 8. Kapacitetet jo të mjaftueshme komunale për zhvillimin e banimit social 9. Kosto e lartë e banimit dhe kualiteti i ndertimit 10. Mungesa e interesimit të grupeve tjera pjesëmarrëse
Mundësitë	Rreziqet
1. Lista e kërkuesve; 2. Lokacioni është i caktuar; 3. Donatorët; 4. Identifikimi I banesave private që janë të lira; 5. Programe të përbashketa me partner nderkombetar në fushen e banimit 6. Programet në nivel qendror në mbështetje në nivel lokal nga fusha e ndertimit (banimit) 7. Themelimi i sektorit te banimit 8. Skemat garantues	1. Jo stabiliteti politik 2. Rritja e numrit të kërkesave; 3. Dëmtimet e paparashikuara gjatë asaj periudhe të banimit; 4. Mosrealizimi i programeve për mungesë të fondeve; 5. Niveli i lartë i varferisë 6. Problemet e vazhdueshme ekonomike dhe finansiare 7. Paapunësia dhe mungesa e punësimit 8. Trendi i rritjes së numrit të popullsisë

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TREVJEÇAR TE BANIMIT (PËRMBLEDHJE)

Në tabelën e mëposhtme është prezantuar realizimi i objektivave të ndarë në veprime

PROGRAMI KOMUNAL TRE VJEÇAR I BANIMIT	Objektivat e programit trevjeçar të banimit								
	Objektiv a	Veprimet	Prioriteti	Treguesit e suksesit	Mjetet e verifikimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor	Burimet financiare
	O 1.1 Përcaktimi i parcelave komunale për ndërtim, pronë komunale	1. Marrja e Vendimit nga kryetari i komunes për formimin e komisionit për identifikim të pronës komunale për ndërtim të objektit. 2. Identifikimi i pronës komunale. 3. Vendimi komunal për ndarjen e parcelës për ndërtim	I lartë	1. Formimi i Komisionit funksional. 2. Formimi i listës së pronave komunale 3. Vendimi i asambelsë komunale	Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë fushë.	Kuvendi Komunes Kryetari, Drejtoria përkatëse	Kryetari Komunes.	2019	Komuna (nuk ka kosto shpenzimi)
	O 1.2 Ndërtimi i objektit banesor për dhënie me qira profitabile	1. Marrja e Vendimit për ndërtim të objektit kolektiv. 2. Hartimi i kushteve urbanistike dhe detyrës projektuese 3. Shpallja e tenderit për hartimin e projektit të ndërtimit. 4. Përzgjedhja e projektit kryesor për implementim	I lartë	1. Vendimi i Asamblesë. 2. Shkresa e DUKMM 3. Oferta publike në bazë të cilës përgatiten dhe dorëzohen projektet 4. Kopja fizike e	-	Kuvendi Komunes Kryetari DUKMM Zyra e Prokurimit.	DUKMM Zyra e prokurimit.	2019 - 2021	Komuna MPMH.

	5. Nënshkrimi i Kontratës mes AK dhe OE. si fitues i tenderit për hartim të projektit kryesor. 6. Shpallja e tenderit për ndërtim të objektit. 7. Përzgjedhja e OE për ndërtim të Projektit 8. Nënshkrimi i Kontratës mes AK dhe OE		projektit kryesor 5. Kontrata e nënshkruar. 6. Oferta publike 6. Caktimi i OE. 7. Kontrata e nënshkruar.					
O 1.3 Vlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve në përputhje me UA, Nr.18/2010 të Ligjit Nr.03/L-164	1. Formimi i Komisionit për vlerësim. 2. Vlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve me qëllim të vazhimit ose ndërprerjes së Kontratave 3. Përpilimi i listës përfituese. 4. Largimi i familjeve që nuk plotësojnë kriteret. 5. Nënshkrimi i Kontratave	I lartë	1. Formimi i Komisionit funksional. 2. Lista e vlerësimit të gjendjes ekonomike të familjeve 3. Lista e përfituesve 4. Vendimi për largim. 5. Kontrata e nënshkruar	-	Kryetari, Komisioni , Inspektorati	Kryetari, MMPH, Drejtoria përkatëse	2019 - 2021	Komuna (nuk ka kosto shpenzimi)
O 1.4 Mbështetja e zgjidhjes së çështjes së banimit përmes "bonus banimit"	1. Caktimi i vlerës së bonusit për vitin buxhetor. 2. Formimi i Komisionit për identifikimin e banesave - shtëpive. 3. Hartimi i listës së banesave-shtëpive të mundshme për	I lartë	1. Vendimi i mbi caktimin e vlerës. 2. Vendimi i. Lista përfundimtare. 3. Mbajtja	-	Spektori i banimit apo zyrtari përgjegjës, Komisioni	MMPH, Komuna, Drejtoria përkatëse.	2019 - 2021	Komuna, MMPH

		dhënie me qira. 4. Kontaktimi me pronarët e banesave - shtëpive. 5. Përpilimi i marrëveshjes me pronarët për shfrytëzimin e banesave me qira përmes bonusit.		e takimeve me pronarë. 4. Marrëveshja a po Kontrata mes Komunës dhe palëve.					
	O 1.5 Formimi sektorit të banimit apo caktimi i zyrtarit përgjegjës për çështjen e banimit.	1. Kryetari i komunës formon sektorin e banimit apo cakton zyrtarin përgjegjës.	I lartë	1. Vendimi komunal	-	Kryetari Komunës Drejtoria përkatëse	Komuna, Kryetari, Drejtoria përkatëse	2019 - 2021	

PERFUNDIMI:

Komuna e Drenasit, ka qenë në mesin e atyre komunave që asnjëherë deri më tash nuk a ka hartuar ndonjë Program për banim social të qytetarëve. Ka qenë nevojshme që edhe kjo komunë të harton një Program tre vjeçar për banim. Kështu, kryetari i komunës, ka marr vendim për formimin e komisionit i cili do të hartoj Programin 3 vjeçar për banim social dhe me këtë program të kemi të drejtë të konkurrojmë për ndonjë donacion për ndërtimin e një objekti social gjatë këtyre tre vjetëve. Nevoja për hartimin dhe zbatimin e efektshëm i Programit për banim sipas programeve të veçanta kërkon koordinimin e aktivitetet të të gjithë akterëve në kuadër të komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Në këtë drejtim është e domosdoshme formimi i Sektorit të banimit si një organ përgjegjës, që në mënyrë aktive të zhvilloj procesin e zbatimit të aktiviteteve sipas këtij Ndërtimi i njësive të reja të banimit sipas standardeve përmes fondeve nga buxheti komunal, Qeverisë dhe në Partneritet publiko-privat, që do të siguroj banim për grupe të caktuara, dhe të u dilet në ndihmë në strehimin e këtyre kategorive të marginalizuara.

Bazuar në këtë, zhvillimi i banimit orientohet nga këto parime:

- përkrahja në zgjidhjen e çështjes së banimit dhe banimit me qira joprofitabile ose në bonues të banimit për banesat me qira të ulët.
- Stimulimi o ofertës dhe kërkesës,
- Mbështetje për grupet e rrezikuara për zgjidhjen e problemit të banimit,
- Rritja e ofertës së banesave joprofitabile, zvoglimin-kufizimin e profitit nga ndërtimet, por jo të rrezikohet interesi i investitorëve që të zhvillojnë aktivitetet ndërtimore të banimit,
- Mirëmbajtja dhe menaxhimi i ndërtesave për banim social.